



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborní Panel za Žalbe i Predstavke

Zl.Anr.60/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Afijete Sada-Gllogjani dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së banerit mbi rrugë publike, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 26.09.2017, mori këtë:

#### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e subjektit politik Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, dega në Ferizaj, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 950.00 (nëntëqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

#### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 25.09.2017, nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me të cilën pretendon se me datë 24.09.2017, në rrugën kryesore në hyrjen e fshatit Bibaj, monitoruesit e KDI kanë hasur në pano të kandidatëve për anëtar të kuvendit komunal dhe kandidatit për kryetar nga Lidhja Demokratike e Kosovës të vendosur mbi rrugë publike.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 33 par.1 pika b), e LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur dy fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë, të datës 25.09.2017, LDK ka theksuar se shkelja e supozuar ka ndodhur si rezultat i mos informimit të plotë të kandidatës në fjalë edhe pse shtabi qendror i zgjedhjeve i LDK-së, ka ndërmarr veprime me qëllim të njoftimit të të gjitha degëve të partisë në të gjitha komunat dhe kandidatet e tyre.

Gjithashtu, ka theksuar se ka kërkuar nga dega përkatëse dhe kandidatja në fjalë që të ndërmarr masa për të evituar shkeljen e supozuar.

Në mbështetje të pretendimeve ka bashkangjitur tri fotografi ku shihet se është larguar baneri nga vendi ku ka qenë i vendosur.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoj se:

**Ankesa është e bazuar**

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se baneri i kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal dhe kandidatit për kryetar nga radhët e subjektit politik LDK, është vendosur mbi rrugë publike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga prova e ofruar shihet qartë se nga ana e subjektit politik LDK, është shkëlur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që baneri i kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal dhe kandidatit për kryetar nga radhët e subjektit politik të LDK-së, është vendosur mbi rrugë publike, e të cilën shkelje e ka pranuar edhe vetë subjekti politik në përgjigjen në ankesë të datës 25.09.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se për kundër këtij fakti baneri i kandidatëve të këtij subjekti politik është vendosur mbi rrugë publike.

Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që e kanë tërhequr banerin nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

ZI Anr. 60/2017, më datën 26.09.2017.



**Kryesuesi i Panelit**  
Zyheri Haxiri

***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4 të LZP-së.***